

## POLITICAL APATHY - NON-USE OF THE RIGHT TO VOTE IN POLLOG REGION

Gjylten Ademi

Faculty of Contemporary Social Sciences, SEEU, Macedonia, [gjyltenademi@gmail.com](mailto:gjyltenademi@gmail.com)

**Abstract:** If there is one area in which the theory of democracy has strong evidence and numerous of them, it is the field of electoral behavior. This and the field of public opinion, as electoral participation components and part of the democratic theory, in general these are that leads us to an overview of political apathy, depoliticization, indifference, decommissioning the right to vote, political apathy, etc.. On the other hand we witness that recently such phenomenon (read: political apathy) is present not only in our country but also in other countries that have high democratic tradition. While taking into the consideration the fact that these phenomena have not been studied enough in our society, I believe that this work will contribute a little in the area of political apathy study as well as for politology. The purpose of this paper is to give an overview of the more sober and objective in relation not only to the degradation of political apathy as a social phenomenon but also analyzing it with a planning tool like cause-effect in order to protect participation. The greater participation in elections is, the greater it demonstrates the level of political culture of the people, however through this also proves an effective and functional democracy. This subject is complex as well as interesting, at any time and space, creates opportunity for debate and analysis.

**Keywords:** Political apathy, Failure to use the right to vote, Participation in elections, Political parties.

## APATIA POLITIKE - MOSSHFRYTËZIMI I TË DREJTËS SË VOTËS NË RAJONIN E POLLOGUT

Gjylten Ademi

Faculty of Contemporary Social Sciences, SEEU, Macedonia, [gjyltenademi@gmail.com](mailto:gjyltenademi@gmail.com)

**Përmbledhje:** Nëse ka një fushë në të cilën teoria e demokracisë ka prova të forta dhe shumë prej tyre, është fusha e sjelljes zgjedhore. Kjo dhe fusha e opinionit publik, si pjesë përbërëse e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe pjesë e teorisë demokratike, në përgjithësi janë ato që na çojnë në një pasqyrë të apatit politik, depolitizimit, indiferencës, çmontimit të së drejtës së votës, apatisë politike etj. Nga ana tjetër ne dëshmojmë se kohët e fundit, një fenomen i tillë (lexohet: apatia politike) është e pranishme jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende të tjera që kanë traditë të lartë demokratike. Ndërsa duke marrë në konsideratë faktin se këto fenomene nuk janë studiuar mjaftueshëm në shoqërinë tonë, besoj se kjo punë do të kontribuojë pak në fushën e studimit të apatiave politike, si dhe për politologjinë. Qëllimi i këtij dokumenti është të japë një pasqyrë të më të matur dhe objektiv në lidhje jo vetëm me degradimin e apatisë politike si një fenomen social, por gjithashtu duke e analizuar atë me një mjet planifikimi si shkak-efekt për të mbrojtur pjesëmarrjen. Pjesëmarrja më e madhe në zgjedhje është, aq më e madhe tregon nivelin e kulturës politike të popullit, por përmes kësaj dëshmon gjithashtu një demokraci efektive dhe funksionale. Kjo lëndë është komplekse dhe interesante, në çdo kohë dhe hapësirë, krijon mundësi për debat dhe analizë.

**Fjalët kyçe:** Apatia politike, Dështimi për të përdorur të drejtën e votës, Pjesëmarrja në zgjedhje, Partitë politike.

### 1. RISHIKIM I LITERATURES

Apatia është dukuri që ndjek sistemet politike dhe funksionimin e tyre prej fazave më të hershme deri më sot. Vetë nocioni apati (indiferencë) nënkupton gjendjen psikike që karakterizon mungesën e interesimit të njeriut ndaj rrjedhave shoqërore. Kur bëhet fjalë konkretisht për apatinë politike parasegjithash aludohet në mosinteresimin e qytetarëve ndaj rrjedhave politike dhe aktiviteteve konkrete politike siç janë: pjesëmarrja në zgjedhje, ndjekja e gjendjes politike, pjesëmarrja në mbledhjet e organizatave politike etj.<sup>238</sup> Apatia rrjedh nga fjala e Greqisë antike “apathies”, që do të thotë mungesë ndjenje’. Athinasit antik e vlerësonin vëmendjen e qytetarëve derisa e urrenin apatinë. Apatia e zbeh shpirtin publik e kështu është indikator i zbehjes së ‘kapitalit shoqëror’ në shoqëritë moderne. Apatia poashtu e ngadalëson ‘mobilizimin kognitiv’ të qytetarëve i cili është burim i rëndësishëm politik. Andaj nuk është çudi e madhe se përse apatia mes qytetarëve të vendeve demokratike i brengos politikanët, ekspertët dhe

---

<sup>238</sup> Aziri E. *Partitë politike dhe demokracia*, Logos A, (Tetovë, 2004), f. 191-196.

profesorët.<sup>239</sup> Një mënyre tjetër e të quajturit sa i përket këti fenomeni është Apolitizmi (apolitism) – Mospasje interesim për tu përfshirë në çështjet politike, mospasje e interesimit për punët e politikës. Formë mendimi ose veprimi që përjashton politikën si mundësi për ti zgjidhur problemet, madje e shef si burimin e të këqijave të individit, të grupeve dhe të këqijave të shoqërisë në tërësi.<sup>240</sup> Nëse njerëzit zgjedhin lirshëm dhe në numër të madh të mos të marrin pjesë në politikë, kjo është dëshmi e fuqishme se ideali i demokracisë ka nevojë të shqyrtohet. Çfarë nëse indiferenca nuk është zgjedhje e lirë, të mos jemi ne i gjithë problemi? Po në qoftë se ajo që duket si apati është me të vërtetë një qëndrim politik i një tjetër lloji? Çfarë nëse apatia ka dy fytyra?<sup>241</sup> Një mënyrë më e mirë për t'u referuar për apatinë politike të një vendi është të marrin në konsideratë kulturën e tij politike. Nga ana tjetër, kultura politike është disponimi i sjelljes së njerëzve ndaj qeverisë së tyre, dhe aktiviteteve të tjera politike. Apatia politike, nëse është e pakontrolluar, mund të sjellë stagnim në zhvillimin e çdo kombi. Apatia politike e një individi fillon me një mungesë të të kuptuarit të politikës apo të qeverisë në një shkallë të caktuar, dhe për këtë shkak e bën më të vështirë që individi të shoh vlerën e votimit të përgjithshëm, përfitimet dhe / ose kostot e politikave të reja që kanë vendet qeveritare. Kjo e bën individin të shoh atë si iracionale për të fituar njohuri, sepse (gjoja) nuk do të ketë asnjë përfitim (individit do ta shoh këtë si injorancë racionale).<sup>242</sup> Mospjesëmarrja në politikë në kuptimin tradicional (në fjalët mos votim, dhe mos-përfshirje në parti të politike) mund të reflektojë në një zgjedhje të ndërjegjshme ku mund të shihet si një formë e angazhimit politik, apo një formë e apatisë politike, apo në kuptim më të gjerë pakënaqësia me procesin formal politik.<sup>243</sup> Një lloj forme e abstenimit karakterizohet nga një mungesë kolektive e dashurisë ndaj sistemit politik. Mund të hamendësohet që kjo mungesë dashurie vjen nga një ndjenjë lodhjeje përballë një situatë pa rrugë dalje. Kështu ndodh për shembull kur parti të në garë mbajnë të gjitha të njejtin diskurs dhe kur mundësia e një alternative duket kësajsoj e përjashtuar apriori, ky lloj abstenimi është qartazi ai që i lëkund më thellësisht institucionet demokratike. Në këtë stad, në fakt, padrejtësitë demokratike që ne kemi analizuar më lart shkojnë nga shqetësimi në mohim: sistemi nuk konsiderohet më si i papërsosur, por si i keq.<sup>244</sup> Nga e gjitha kjo del në pah se një ringjallje e tillë e mbështetjes për sistemin është një atribut i përhapur i zgjedhjeve. Shteti ka nevojë për të pasur mbështetjen e mjaftueshme të qytetarëve të tij, në mënyrë që autoriteti i tij të vazhdojë pa ndërprerë. Në mënyrë të ngjashme, për demokracitë dhe autokracitë, me sa duket zgjedhjet ofrojnë një instrument të fuqishëm për ta siguruar këtë bazë mbështetje popullore. Në intervale të rregullta, pranimi i sistemit nga qytetarët forcohet, ndërkohë që qytetarët deklamojnë identifikimin e tyre me shtetin dhe drejtuesit e tij.<sup>245</sup> Po në të gjitha demokracitë tabloja që del nga studimet e votimeve dhe anketave është gjithmonë tablo shumë e zymtë e bazës së informacionit – pa le të tjerave – të shumicës së madhe të qytetarëve. Është një përgjithsim pak a shumë i sigurt se apatia ose depolitizimi janë shumë të përhapur, se qytetari i zakonshëm nuk interesohet shumë për politikë, se pjesëmarrje e qytetarëve është minimale, në mos subminimale, dhe se në shumë fusha dhe raste publiku nuk ka opinion të vetin po, më fort, ndjenja të vagëlluara të përbëra nga gjendjesh shpirtërore.<sup>246</sup> Huluntimi i sjelljes zgjedhore zbulon padyshim dobësimin e lidhjeve të identifikimit partiak. Posaçërisht në fillim të viteve të gjashtedhjeta e tutje, në identitetin partiak ka filluar të futen edhe grimca të gjeneratave: votuesit e ri që janë kyçur në shoqëri në vitet e gjashtedhjeta kanë pasur lidhje më pak ndjenjësore me partinë dhe kanë votuar më parë për qendrimit e partive mbi çështjet që i kanë pasur këta përzemër. (Nie, Vepra dhe Petrocik 1976). Edhe në Europë është dobësuar identifikimi me parti të politike.<sup>247</sup> Në SHBA është vënë re së lidhja e fortë me partinë politike pakësohet me kalimin e brezave, që nga koha e Depresionit të Madh, kohë që shënon edhe pikun e besnikërisë dhe lidhjeve partiake, dhe kur partia demokratike kishte shumicën.<sup>248</sup> Gjithsesi, duket se në këtë lojë të ndërlikuar ndërmjet të përfaqësuarve dhe përfaqësuesve janë pikërisht këta të dytë që kanë përforcuar fuqinë e vet. Huluntimet, që janë marrë me parti në demokracitë perendimore, kanë vërtetuar se ka ardhur gjithashtu

<sup>239</sup> Latifi, V. *Politikologjia*. Universiteti FAMA, (Prishtinë, 2008), f. 457.

<sup>240</sup> Pajaziti, A. *Fjalor i Sociologjisë*, Logos A, (Tetovë, 2009), f. 47.

<sup>241</sup> DeLuca, Tom. *The Two Faces of Political Apathy*, United States of America, (1995).

<sup>242</sup> Pasek, Josh. *America's Youth and Community Engagement: How Use of Mass Media Is Related to Civic Activity and Political Awareness in 14- to 22-Year-Olds*, Communication Research. Retrieved 4 December 2011. Marrw nga: [http://en.wikipedia.org/wiki/Political\\_apathy](http://en.wikipedia.org/wiki/Political_apathy)

<sup>243</sup> *Revisiting youth political participation* Council of Europe, March 2005, Marrw nga: [http://youth-partnership.eu.coe.int/youthpartnership/documents/EKCYP/Youth\\_Policy/docs/Citizenship/Research/Revisiting\\_youth\\_politica.pdf](http://youth-partnership.eu.coe.int/youthpartnership/documents/EKCYP/Youth_Policy/docs/Citizenship/Research/Revisiting_youth_politica.pdf)

<sup>244</sup> Jean-Marie Denquin. *Hyrje në Shkencat Politike*, UET Press, (Tiranë), f. 73.

<sup>245</sup> W. Philips Shiveley. *Hyrje në shkencat Politike Pushteti dhe Zgjedhja*, Aais, (Tiranë, 2012), f. 299.

<sup>246</sup> Sartori, Gjovani. *Edhe një herë për Teorinë e Demokracisë*, Dituria, (1998), f. 121-132

<sup>247</sup> Donatella Della Porta. *Bazat e Shkencës Politike*, Victory, (Prishtinë, 2006), f.157.

<sup>248</sup> Matha – Cottam – Beth Dietz-Uhler – Elena M. Mastors – Thomas Preston. *Hyrje në Psikologjinë Politike*, UFO Press, (Tiranë, 2009),

edhe deri te rënia e numrit të antarëve edhe pse me dallim të madh ndër shtete të ndryshme. Kësaj duhet shtuar se botëkuptimet nuk i ndryshojnë vetëm ata të cilët tregojnë interesim më të vogël politik. Siç ka konstatuar Daltoni (1996) lidhshmëria ndaj partisë është zvogëluar edhe në mesin e atyre që nuk interesohen për politikë por edhe në mesin e atyre që e ruajnë këtë interesim. Siç tregojnë hulumtimet e sotme, trupi besnik zgjedhorë, i ashtuquajtur baza e fortë e partisë anon kah shkatërimi, dhe rritet trupi zgjedhor i opinionit. i cili voton në bazë të afinitetit të posaçëm ndaj programit me të cilin partitë përkushtohen çështjes së caktuar, dhe të cilët janë të gatshëm që në zgjedhje të posaçme edhe ta ndryshojnë partinë duke e ruajtur kështu trupin zgjedhor të opinionit, pra zgjedhësit që votën vetë e zavendësojnë me shërbime (Kartocci 1994). Kjo na çon të mendojmë se krahas nivelit të shkollimit dhe demokratizimit kulturor është zmadhuar edhe numri i atyre që mendojnë para se ta japin votën e vet. Në qasjet më të reja *racionale* ndaj politikës votuesi është paraqitur si ai që është i aftë të vlerësojë të arituarat e politikanëve dhe në bazë të këtij vlerësimi edhe të veprojë. Votuesi racional di të vlerësojë partinë dhe ta zgjedhë atë që i përshtatet më së shumti dëshirave te tija.<sup>249</sup>

## 2.METODOLOGJIA

Gjatë hulumtimit janë përdorur metoda dhe teknika bazë të studimit shkencorë: analiza dhe sinteza, induksioni dhe deduksioni, metoda historike, metoda komparative, metoda statistikore si dhe pyetëtori si një nga teknikat bazë dhe më gjerësisht të përdorura të hulumtimit shkencorë. Metoda që është përdorur gjatë këtij hulumtimi shkencor për mbledhjen e të dhënave është: anketimi i bërë me një gamë të gjërë të qytetarëve banorë të pollogut me gjithsej 1000 qytetarë gjatë periudhes se vitit 2014. Procesi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave shkencore është bërë me anë të programit statistikor **SPSS** (The Statistical Package for the Social Sciences).

<b>1. Mosha</b>	a)18-25 <b>49%</b>	b) 26 – 33 <b>25%</b>	c) 34 – 41 <b>12%</b>	d) 42-49 <b>7%</b>	e) 50 e më shumë <b>7%</b>
<b>2.Gjinia</b>	a) Mashkul <b>57%</b>	b) Femër <b>43%</b>			
<b>3. Nacionaliteti</b>	Shqiptar <b>80%</b>	b) Maqedonas <b>15%</b>	c) Turk <b>4%</b>	d) Tjetër <b>1%</b>	
<b>4. Niveli arsimor</b>	a) Fillor <b>9%</b>	b) Mesëm <b>36%</b>	c) Deridiplomik <b>47%</b>	d)Postdiplomik <b>8%</b>	
<b>5. Angazhimi politik</b>	a) Politikisht aktiv <b>12%</b>	b) Politikisht i përcaktuar <b>21%</b>	c) Politikisht i pa përcaktuar <b>43%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>24%</b>	
<b>6. A jeni të kënaqur me veprimin e partive politike në RM?</b>	a) Po <b>13%</b>	b) Pjesërisht <b>29%</b>	c) Jo <b>51%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>7%</b>	
<b>7. A mendoni se partitë politike janë bartëse të proceseve demokratike?</b>	a) Po <b>24%</b>	b) Pjesërisht <b>32%</b>	c) Jo <b>32%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>12%</b>	
<b>8. A mendoni se në RM ekziston një profilizim i qartë i partive politike?</b>	a) Po <b>15%</b>	b) Pjesërisht <b>26%</b>	c) Jo <b>42%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>17%</b>	
<b>9. Amendoni se bipolarizimi në baza etnike i ndihmon proceset integruese të RM?</b>	a) Po <b>21%</b>	b) Pjesërisht <b>25%</b>	c) Jo <b>32%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>22%</b>	
<b>10. A e arsyetoi funksionimin e partive politike nacionale?</b>	a) Po <b>26%</b>	b) Pjesërisht <b>24%</b>	c) Jo <b>32%</b>	d) Nuk kam përgjigje <b>18%</b>	

<sup>249</sup> Donatella Della Porta. *Bazat e Shkencës Politike*, Victory, (Prishtinë, 2006), f.157.


11. A mendoni se partitë politike janë nxitese të konflikteve,ndëretnike, ndërkulturore.ndërfetare?	a) Po 57%	b) Pjesërisht 21%	c) Jo 14%	d) Nuk kam përgjigje 8%
12. A e keni shfrytëzuar të drejtën e votës deri më sot?	a) Po 79%	b) Pjesërisht 12%	c) Jo 9%	
13. Në qoftë se e keni shfrytëzuar të drejtën e votës cilët janë motivet?	a) Obligim qytetar. 52%	b) Besimi tek subjektet garuese se do ta ndryshojnë gjendjen në dobi të qytetareve. 34%	c) I shtyrë nga motive të tjera. 14%	
14. Në qoftë se nuk e keni shfrytëzuar te drejtën e votës cilat kanë qënë motivet?	a) Nuk kam pasur kohë të dal në votim. 18%	b) I deshpruar nga premtimet e parealaziuara të partive politike. 48%	c) Arsye të tjera. 34%	
15. A mendoni se mosshfrytëzimi i të drejtës së votës është një e drejtë demokratike për qytetaret?	a) Po 55%	b) Jo 29%	c) Nuk kam përgjigje 16%	
16. A mendoni se mosshfrytëzimi i të drejtës së votës i dëmton subjektet politike?	a) Po 56%	b) Jo 30%	c) Nuk kam përgjigje 14%	
17. A mendoni se indiferenca politike ndërlidhet me kulturën politike të qytetareve?	a) Po 36%	b) Pjesërisht 33%	c) Jo 13%	d) Nuk kam përgjigje 18%
18. A mendoni se indiferencën politike qëllimisht e provokojnë subjektet politike?	a) Po 41%	b) Pjesërisht 24%	c) Jo 14%	d) Nuk kam përgjigje 21%
19. A mendoni se pjesëmarrja sa më masive në zgjedhje e ngrit nivelin e demokracisë dhe e vënë kontrollë punën e partive politike dhe subjekteve tjera në procesin zgjedhorë?	a) Po 45%	b) Pjesërisht 23%	c) Jo 16%	d) Nuk kam përgjigje 16%
20. Çfarë masash duhet ndërmarur për tejkalimin e indiferences politike?	a) Masa juridike. 21%	b) Informim më të drejtë dhe më cilësorë të opinionit publik për rëndësinë e zgjedhjeve. 29%	c) Emancipimin e qytetarëve për rrolin dhe rëndësinë e zgjedhjeve. 21%	d) Nuk kam përgjigje. 22%

*Tabela1. Rezultatet e anketës me përqindje.*

Apatia politike në njëfarë mënyre shihet edhe nga përqindja e votuesve që marin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, vendore dhe qendrore. Mosshfrytëzimi i të drejtës së votës është vetëm një segment që ndërlidhet me apatinë politike, megjithatë kjo është formë manifestuese. Zbulimi i shkaqëve dhe motiveve është proces tejet i ndërlikuar

që kërkon angazhim më të madh e më serioz.<sup>250</sup> Për vitin 2014 ishin të parapara zgjedhjet Presidenciale të cilat duheshite të mbahen diku kah mesi i Prillit. Mirëpo për shkak të mospranimit të propozimit të partnerit të koalicionit qeveritar nga blloku shqiptar për President koncensual nga partia në pushtet nga blloku politik maqedonas, Parlamenti sërisht u shpërnda dhe bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve Presidenciale u caktuan edhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare për vitin 2014. Nga 1.780.128 qytetarë me të drejtë vote, **63%** e tyre apo 1.120.744 dolën dhe dhanë legjitimitetin se kush do t'i udhëheq në 4 vitet e ardhshme<sup>251</sup>. Mirëpo dalja nuk ishte e njëjtë edhe për zgjedhjen e Presidentit të shtetit. Vetëm **54%** apo 967.694 qytetarë dhanë votën e tyre për zgjedhjen e Presidentit<sup>252</sup>. Ky dallim i madh në këto dy cikle zgjedhore vijnë si rezultat i bojkotit dhe thirrjes së partisë më të madhe në bllokun shqiptar që mos të votohet President i njëanshëm. Ky lloj abstenimi si në rastin e lartë përmendur është formë e ashtuquajtur abstenim luftarak. Ai manifestohet kur një formacion politik u jep idhtarëve të vet rekomandimin e hapur për të abstenuar<sup>253</sup>

Të paktën në rajonin e pollogut 79% e të anketuarve pranojnë se ato kanë shfrytëzuar të drejtën e votës derri më sot, 12% kanë konfirmuar për pjesërisht si dhe vetëm 9% janë përgjigjur se deri më sot nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës. Sipas rezultateve të arituar 52% nga të anketuarit motivi kryesor i cili shtyn qytetarët të dalin në votim është se e kanë për obligim qytetarë, 34% e të anketuarve si motiv kanë besimin tek subjektet garuese se do ta ndryshojnë gjendjen në dobi të qytetarëve, ndersa vetem 14% shprehen se janë të shtyrë nga motive të tjera. Motivet e atyre që nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës 48% konfirmojnë se janë të dëshpëruar nga premtimet e pa realizuara të partive politike. Sipas kësaj analize ne arrijmë në përfundim se motivi me numër përqindje më të madhe të anketuarve në rajonin e Pollogut, është dëshperimi nga premtimet e pa realizuara të partive politike ose thënë ndryshe mosbesimi në partitë politike, fenomen ky që sipas rezultateve të hulumtimeve të bëra në vendet ballkanike na paraqitet si karakteristikë.



**PYETJE TË KRYQËZUARA- REZULTATE TË ANKETËS ME ANË TË METODËS KOMPARATIVE.**

**Grafikoni 1.** Niveli arsimor \* A e keni shrytëzuar të drejtën e votës deri më sot? Nga rezultatet e marura në pyetjen a e keni shfrytëzuar të drejtën e votës deri më sot gëzon fakti se ktë të drejtë në përqindje më te madhe e kanë shfrytëzuar zgjedhësit me arsimim të larte kjo është pozitive nga shkakut se kjo kategori e qytetarëve është bartësja kryesore e aktiviteve demokratike në vend.

<sup>250</sup> Aziri, E. *Partitë politike dhe demokracia*, Logos A, (Tetovë , 2004), f. 191-196.  
<sup>251</sup> Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet parlamentare 2014, Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>  
<sup>252</sup> Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet presidenciale 2014, Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>  
<sup>253</sup> Jean-Marie Denquin. *Hyrje në Shkenca Politike*, UET Press, (Tiranë) f.72.



Gjithashtu sa më i lartë të ishte niveli i edukimit të njerëzve, aq më i lartë niveli i tolerancës që tregonin ata. Stouffer argumentonte se shkollimi u mëson njerëzve të mos i shohin të tjerët nëpërmjet stereotipeve, të mos i kategorizojnë njerëzit nëpërmjet grupeve në mënyrë të ngurtë dhe të respektojnë pikëpamjet e ndryshme.<sup>254</sup>

**Grafikoni 2. Moshë\*** Në qoftë se nuk e keni shfrytëzuar të drejtën e votës cilat janë motivet? Gjatë anketimit të qytetarëve të grupmoshave të ndryshme, arsyet të tjera si dhe dëshpërimi nga premtimet e pa realizuara të partive politike ishin motivet kryesore që shkaktojnë indiferencën apo abstenimim, kurse vetëm një pakicë dëshmon se ata nuk kanë shfrytëzuar të drejtën e votës për shkak se nuk kanë pasur kohë për të dalë në

## PËRFUNDIME DHE KONKLUZIONE

- Apatia dhe mosshfrytëzimi i të drejtës së votës është një fenomen global, çka do të thotë se në forma dhe mënyra të ndryshme e hasim te të gjitha shoqëritë që e praktikojnë pluralizmin politik dhe partiak.
- Shkaqet dhe motivet që sjellin deri te apatia politike dallojnë prej shteti në shtet dhe zakonisht kushtëzohen nga më shumë faktorë siç janë: niveli i kulturës politike të qytetarëve, zhvillimi shoqëror politik, funksionimi i shtetit të së drejtës, lodhja e qytetarëve nga zgjedhje të shpeshta, mosbesimi i qytetarëve ndaj subjekteve politike participante në garat zgjedhore etj.
- Apatia dhe mosshfrytëzimi i të drejtës së votës kanë zgjuar dhe zgjojnë interesimin e hulumtuesve por edhe strukturave shtetërore në disa shoqëri me demokraci të avansuar, këtë e dëshmojnë hulumtimet e shumta dhe permanente që bëhen gjithandej në botë dhe ndërmarrja e masave juridike për qytetarët që nuk e shfrytëzojnë të drejtën e votës siç është rasti në disa vende skandinave.
- Apatia politike dhe mosshfrytëzimi i të drejtës së votës nuk janë fenomen identik sepse apatia nënkupton indiferenc ndaj proceseve politike dhe politikbërjes ndërsa mosshfrytëzimi i së drejtës së votës revolt ndaj garniturave që janë dominante në sjelljen e vendimeve një periudhë më të gjatë ose me të shkurter kohore.
- Mosshfrytëzimi i të drejtës së votës për fat të keq nga njëherë është rezultat i bindjes së qytetarëve por ka raste kur është edhe rezultat i pamundësisë të qytetarëve ta shfrytëzojnë të drejtën e votës si një e drejtë historike dhe legjitime, kjo e dyta është karakteristike për vendet me demokraci të brishtë ku bëjnë pjesë edhe disa shtete që në fund shekullin e kaluar sistemet moniste i zavendësuan me ata pluralisto partiake.
- Republika e Maqedonisë sa i perket mosshfrytëzimit të drejtës së votës dallon si nga shtetet me demokraci të avansuar ashtu dhe nga fqinjët e saj, shiquar në kontinuitet në këtë aspekt vërehen batica dhe zbatica të shprehura.
- Moshfrytëzimi i votës në rajonin e Pollogut është i determinuar nga shumë rrethana specifike që nderlidhen me këtë hapsirë gjeografike.
- Nga rezultatet e hulumtimeve empirike vërehet qartë se per participim ne zgjedhje interesim më të shprehur tregojnë gjinia mashkullore, në kuptimin e grupmoshave më të rinjtë, ndersa sa i takon statusit social shtresat më të varfura.
- Analizat e bera flasin qartë se sa i perket popullatës shqiptare mosinteresimi për shfrytëzimin e të drejtës së votës është më shumë i imponuar nga partitë politike se sa diçka qe ka të bej me profilin e votuesit shqiptar. Partitë politike shqiptare prej fillimit të jetës pluraliste më shumë kanë qenë të koncentruara “në marjen e votës” nga qytetarët shqiptar se sa krijimi i një atmosfere relaksuse ku qytetari shqiptar do te ndjehej si pjesë integruese e proceseve të politikbërjes.
- Për një eliminim sa më efikas të apatisë politike në rajonin e Pollogut propozojmë ndermarjen e aktiviteteve emancipuese për qytetaret me të drejtë vote si nga ana e subjekteve politike ashtu dhe nga sektori jo qeveritar.
- Parite politike duhet të vetëdijsohen se apatia politike paraqet një njollë të zezë në demokratizimin e Maqedonisë në përgjithësi dhe rajonit të saj përfshirë këtu edhe rajonin e Pollogut.
- Republika e Maqedonisë në kuptimin e shfrytëzimit të drejtës së votës sa më parë duhet të miraton një ligj të veçantë i cili nga njëra anë do të stimulonte qytetarët për pjesëmarrjen ne zgjedhje por nga ana tjetër dhe do ti ndëshkonte të gjithë ata të cilët nuk e shfrytëzojnë të drejtën e votës si një vlerë demokratike.

---

<sup>254</sup> Matha – Cottam – Beth Dietz-Uhler – Elena M. Mastors – Thomas Preston. *Hyrje nw Psikologjinw Politike*, UFO Press, (Tiranw, 2009), f. 129-157.

**LITERATURA**

- [1] Aziri E. *Partitë politike dhe demokracia*, Logos A, (Tetovë , 2004), f. 191-196.
- [2] Latifi, V. *Politikologjia*. Universiteti FAMA, (Prishtinë, 2008), f. 457.
- [3] Pajaziti, A. *Fjalor i Sociologjisë*, Logos A, (Tetovë, 2009), f. 47.
- [4] DeLuca, Tom. *The Two Faces of Political Apathy*, United States of America, (1995).
- [5] Pasek, Josh. *America's Youth and Community Engagement: How Use of Mass Media Is Related to Civic Activity and Political Awareness in 14- to 22-Year-Olds*, Communication Research. Retrieved 4 December 2011. Marrw nga: [http://en.wikipedia.org/wiki/Political\\_apathy](http://en.wikipedia.org/wiki/Political_apathy)
- [6] *Revisiting youth political participation* Coucil of Europe, March 2005, Marrw nga: [http://youth-partnership.eu.coe.int/youthpartnership/documents/EKCYP/Youth\\_Policy/docs/Citizenship/Research/Revisiting\\_youth\\_politica.pdf](http://youth-partnership.eu.coe.int/youthpartnership/documents/EKCYP/Youth_Policy/docs/Citizenship/Research/Revisiting_youth_politica.pdf)
- [7] Jean-Marie Denquin. *Hyrje në Shkencat Politike*, UET Press, (Tiranë ), f. 73.
- [8] W. Philips Shiveley. *Hyrje në shkencat Poltike Pushteti dhe Zgjedhja*, Aais, (Tiranë, 2012), f. 299.
- [9] Sartori, Gjovani. *Edhe një herë për Teorinë e Demokracisë*, Dituria, (1998), f. 121-132
- [10] Donatella Della Porta. *Bazat e Shkencës Politike*, Victory, (Prishtinë, 2006), f.157.
- [11] Matha – Cottam –Beth Dietz-Uhler – Elena M. Mastors – Thomas Preston. *Hyrje nw Psikologjinw Politike*, UFO Press, (Tiranw, 2009).
- [12] Komisioni shtetëror zgjedhor – Zgjedhjet presidenciale 2014, Marrë nga: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>

